

DIPLOMË PROFESIONALE NË EFIÇENCË ENERJITIKE (120 ECTC, 2 vite akademike)

Universiteti POLIS në kuadër të projektit TEMPUS, ofron program studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 120 (njëqind e njëzet) kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kohëzgjatja e të cilit është 2 (dy) vite akademike.

Në përfundim të programit profesional të studimit lëshohet "Diplomë profesionale" në përputhje me rregulloret përkatëse të Universitetit POLIS.

Profili profesional

Ky program profesional synon të japë njohuri formuese dhe praktike bazë mbi çështje dhe fenomene që lidhen me eficiencën e energjisë në përgjithësi e sidomos në banesë, të përgatisë studentët në formimin e një aftësie praktike në një fushë të rëndësishme si ajo e përdorimit të energjisë me leverdi ekonomike në banesa, ti ndërgjegjësojë në çështjet e përdorimit racional (me eficiencë) të energjisë dhe futjen e metodave llogaritëse në drejtim të selektimit të impjantit energjetic, me qëllim reduktimin e karbonit dhe përdorimin e energjive të rinovueshme si e ardhmja e energjisë së pastër. Programi synon gjithashtu të përgatisë teknikë të aftë për të kryer operacione praktike në terren që lidhen me këtë fushë.

Temat kryesore që trajton ky program studimi:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm;
- Kode dhe Standarte Europiane dhe Lokale në Eficiencë Energjitike;
- Bazat e Eficiencës Energjitike;
- Cilesia e ambientit të brendshëm etj.;
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues;
- Sistemet HVAC; Auditim energjetic; Certifikim Energjetic; Teknologji Arkitekture dhe Ndërtimi;
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese;
- Energjite e Rinovueshme; Retrofiti i ndërtesave; Instalime dhe Rregulla të Sigurisë etj.;
- Punë praktike dhe intership profesional.

Mundësitë për punësim

Duke qenë një program profesional me fokus të veçantë praktikën profesionale programi në tërësi synon përgatitjen teknike profesionale të studentëve në eficiencë energjitike. Ky profesion apo "zanat" është shumë i kërkuar sot në tregun e punës dhe që realisht mungon në ofertën akademike kombëtare.

Në këtë kuptim shanset për punësim janë të mëdha në sektorë të ndryshëm si : sektori publik (bashki e komuna), sektori privat si biznese ndërtimi, kompani të instalimeve elektrike dhe HVAC , NGO shqiptare dhe të huaja që merren me zbatimin e projekteve në terren, etj.

Programi është shumë praktik dhe studentët në dalje janë të gatshëm për të filluar punë e për të aplikuar njohuritë e marra në shkollën profesionale.



Plani Mësimor sipas Tipeve të Veprimtarive në Programin e Studimit Profesional në Efiçencën Energjitike				
Fusha disiplinore	Veprimtari formuese	Kredite	Kredit e total	Kredite (%)
A (formim baze i pergjithshem)	Bazat e Eficenses Energjitike	3	18	15%
	Gjuhe e huaj - Anglisht	6		
	Kode dhe Standarte Europiane dhe Lokale ne Eficence Energjitike	3		
	Cilesia e Ambientit te Brendshem	6		
		18		
B (karakterizuese)	Fizike e Aplikuar	6	39	33%
	Teknologji Arkitekture dhe Ndertimi	6		
	Sistemet HVAC	6		
	Energjite e Rinovueshme	3		
	Autocad	6		
	Auditim Energjistik	6		
	Certifikim Energjistik	6		
		39		
C (praktike)	Internship	12	24	20%
	Praktike Laboratorike	12		
		24		
D (integruese)	Menaxhim Biznesi	3	12	10%
	Lende me perzgjedhje	3		
	Retrofiti i Ndertesave	6		
Total C		12		
E (formuese plotesuese)	Mirembajtje	6	12	10%
	Instalime dhe Rregulla te Sigurise	6		
		12		
F (pergatitja tezes)	Projekti final	15	15	13%
		15		
	TOTAL	120	120	100%

Shënim: Programi mësimor është në proces rishqyrtimi, në bazë të VKM Ne. 879, 18.12.2019 “Për Elementet e Programeve të Studimit”. Kurrikula e reja me ndryshimet minimale që dikton ky vendim do të zbatohen që nga brezi i studentëve që do të fillojnë studimet e tyre nga v. I gjatë vitit akademik 2020-2021, dhe në vazhdim.